



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Skrapar, më 17/04/2025

PROJEKT - VENDIM

**“PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE NGA BASHKIA SKRAPAR PËR
SHTETASIN GRAMOS ISLAMLLARI”**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Vendim me Nr.5, datë 07.02.2025 “Për miratimin e detajimit të fondeve të trashëguara nga viti 2024 në vitin 2025, për Bashkinë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj” për mbulimin e një pjese të shpenzimeve për kurim për shtetasin **Gramos Islamllari**, Kryetari I Bashkisë:

PROPOZON

1. Miratimin e ndihmës financiare në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për shtetasin Gramos Islamllari.
2. Vlera prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përdoret nga Bashkia Skrapar nga artikulli 602, zëri shpenzime operative administratë, në programin buxhetor administrim, planifikim, menaxhim.

Ju faleminderit!

**KRYETARI
ADRIATIK MEMA**

Përgjegjëse NE dhe PAK-së
Teuta HYSENBELLIU

Drejtorja Juridike/ Burimeve Njerezore
Rudina LLANGO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

RELACION

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR SHTETASIN GRAMOS ISLAMLLARI
BANOR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇOROVODË, BASHKIA SKRAPAR**

Sektori i Shërbimit Social bazuar në kërkesën e bërë nga shtetasi **Gramos Islamllari** më datë **03.04.2025**, si dhe në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 24, “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, pikal, bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, si dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë me *NR.5, datë 07.02.2025*, për buxhetin e Bashkisë Skrapar dhe institucionet në varësi të saj për vitin 2025 :

JU RELATOJ:

Familja e shtetasit Gramos Islamllari me banim në qytetin e Çorovodës, Bashkia Skrapar, përbëhet prej 4 anëtarësh. Kryefamiljari, bashkëshortja dhe dy djemtë.

Z. Gramos Islamllari prej disa vitesh ka patur probleme të rënda shëndetësore. Është diagnostifikuar me tumor në fshikzën e urinës, ka kryer 3 ndërhyrje kirurgjikale si dhe një ndërhyrje kirurgjikale në fyt në vitin 2024, më pas është trajtuar me rreze dhe kimio-terapi. Ndërhyrjet kirurgjikale dhe trajtimet e shumta mjekësore kanë qënë të kushtueshme dhe të ardhurat që merr familja nuk mund t'i përballojnë. Kryefamiljari trajtohet si Invalid Punc dhe pagesa e invaliditetit nuk mjafton për të përballuar mjekimet për operacionin e radhës.

E ndodhur në këto kushte të vështira sociale – ekonomike dhe në rrezik për shëndetin e Z.Gramos Islamllari, Bashkia Skrapar merr përsipër dhënie e ndihmës financiare në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë

Për sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak dhënie e ndihmës financiare për shtetasin Gramos Islamllari.

Përgjegjëse e NE dhe PAK-së

Teuta Hysenbelliu

